

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË



Nr. 1422 Prot  
Nr. 2241 Dosje

Tiranë, më 29.12.2021

**URDHËR**

(PËR VENIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE)

**Drejtuar :** QENDRËS KOMBËTARE TË BIZNESIT (QKB – TIRANË)

Unë, Florian Shehu, me detyrën e Përmbarduesit Gjyqësor, pranë Zyrës së Përmbardimit Privat “TDR GROUP” sh.p.k, në referim të Vendimit Nr.23-2021-1190(507), të lëshuar me datë 26.07.2021 prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, kam vene ne ekzekutim kete vendim gjyqësor, duke regjistruar ne dosjen permbarimore Nr.2241, date 13.12.2021, kerkesen e kreditorëve Arjan Piro, Shani Piro, Ylli Piro, Vladimir Piro, Rozina Piro, Livia Piro, Ridgers Piro, ndaj debitorit Shoqëria “BISTRICA 3 ENERGY” Sh.p.k.

Pasi është filluar procesi i ekzekutimit të detyrueshëm, duke i dërguar palës debitore Lajmërimin Nr.1361 Prot, Datë 13.12.2021, për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin që përmban Vendimi Nr.23-2021-1190(507), të lëshuar me datë 26.07.2021 prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, në referim të neneve 517 dhe 518 të K.Pr.Civile,

**KONSTATOVA**

Se debitori ka marrë dijeni referuar dispozitave të Kodit të Procedurës Civile për njoftimin e Lajmërimin për Ekzekutimin Vullnetar të Detyrimit dhe nuk i është përgjigjur respektimit të afatit dhe kërkesave të këtij lajmërimi.

Në këto kushte në referim të nenit 527 të K.Pr.Civile duhet të filloj ekzekutimin e detyrueshëm, duke vënë sekuestër mbi aksionet e zotëruara nga debitori Shoqëria “BISTRICA 3 ENERGY” Sh.p.k në masën që do të jetë e nevojshme për plotësimin e detyrimit.

Per sa me siper, ne referim të Ligjit Nr. 26/2019 “Per Sherbimin Permbarimor Gjyqesor Privat”,



QENDRA KOMBETARE  
E BIZNESIT  
Nr. 102  
Prift  
Data 05.05.2017

### URDHËROJ

1. Vendosi e masës së sekuestros konservative mbi të gjitha aksionet e zotëruara nga debitori Shoqëria "BISTRICA 3 ENERGY" Sh.p.k, me NIPT K82118005R.
2. Pas vënies së masës së sekuestros, te informohemi ne lidhje me:
  - a) adresen e ushtrimit te veprimtarise private.
  - b) llojin e aktivitetit per te cilin eshte pajisur me licence.
  - c) bllokimin e shitjes se aksioneve dhe tjetersimit te aktivitetit.
3. Per veprimet apo mosveprimet tuaja, na vini ne dijeni shkreserisht brenda afatit ligjor.
4. Personat që behen pengese, do te pergjigjen ne baze te nenit 606 te K.Pr.Civile (parag.II) që parashikon vendosjen e sanksionit te gjobes dhe kallzimin penal.
5. Kjo kerkese perpilohet dhe mbahet ne disa kopje.

**ZYRA E PËRMBARIMIT PRIVAT "TDR GROUP" sh.p.k.**

**PËRMBARUESI GJYQËSOR**

**FLORIAN SHEHU**



Zyra e Përmbarimit Privat "TDR Group" sh.p.k  
Adresa : Bulevardi "Gjergj Fishta" Kulla Nr. 5 ,Kati i 11-të , Nr.54 Tiranë  
Tel ; 00355 42 427790  
www.tdr.al